



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2020:043402

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05754368

KA.nr.428/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Besimi Commerce” Sh.P.K. me NUI 810623456 dhe seli në rrugën “Ibrahim Rugova” nr. 820 në Shtime, i cili përfaqësohet sipas prokurës nga avokati Kemajl Ademaj me seli në rrugën Sali Çeku nr. 103 në Ferizaj, kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit administrativ, jashtë seancës, më datën 14 maj 2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Ndërpritet procedura e konflikti administrativ, e filluar sipas padisë së datës 18.03.2020 të paditësit “Besimi Commerce” Sh.P.K. me NUI 810623456, kundër të paditurit Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar hedhjen poshtë si të pa afatshëm të vendimit nr. prot. 1201 të datës 14.01.2020 të së paditurit dhe detyrimin e të paditurit që t’ia njoh të drejtën për përkrahje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017 për nën masën “Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve”, ose që të ndryshohet vendimi nr. prot. 1201 i datës 14.01.2020 i të së paditurit, ashtu që të detyrohet i padituri që t’ia njoh të drejtën për përkrahje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017 për nën masën “Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve”, deri sa të zgjidhet çështja paraprake.

**A R S Y E T I M**

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës 07.05.2024, Paditësi i ka propozuar gjykatës që të ndërpritet kjo procedurë, deri sa shkalla e dytë gjyqësore të vendos për ankesën e tij ndaj

aktvendimit KA.nr. 428/22 të datës 03.04.2024, meqenëse sipas tij ajo lëndë është e lidhur me këtë lëndë.

Gjykata vëren se Paditësi më 31.01.2020 ka paraqitur kërkesë për vendosje sipas nenit 68 të LKA-së duke pretenduar se i Padituri nuk ka vepruar në afatin prej 30 ditëve për nxjerrjen e aktit të ri administrativ, e as pas afatit 7 ditor nga parashtrimi i kërkesës së veçantë për nxjerrjen e vendimit të tillë sipas vendimit gjyqësor. Ajo lëndë ishte regjistruar së pari në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ndërsa më vonë është bartur në këtë gjykatë me numrin KA.nr. 428/22. Në atë lëndë kjo gjykatë e ka hedhur poshtë si të parakohshme kërkesën e Paditësit për vendosje sipas nenit 68 të LKA-së. Ndaj atij vendimi Paditësi kishte paraqitur ankesë.

Në lëndën konkrete, Paditësi përmes padisë së tij ka kërkuar që të hedhet poshtë si i pa afatshëm të vendimi nr. prot. 1201 i datës 14.01.2020 i të paditurit dhe detyrimin e të paditurit që t'ia njoh të drejtën për përkrahje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017 për nën masën "Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve", ose që të ndryshohet vendimi nr. prot. 1201 i datës 14.01.2020 i të së paditurit, ashtu që të detyrohet i padituri që t'ia njoh të drejtën për përkrahje në Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2017 për nën masën "Sektori i përpunimit të pemëve dhe perimeve".

Gjykata gjithashtu vëren se në të dy lëndët palët janë të njëjta, e kanë të njëjtën gjendje faktike në procedurën administrative, si dhe për të dy lëndët vlen e njëjta e drejtë materiale. Gjykata gjithashtu gjen se lënda tjetër është në fazën e mjetit të goditjes, atëherë gjykata vlerëson se trajtimi i kësaj lënde rrezikon krijimin e situatës në të cilën gjykata duhet të vendos dy herë për të njëjtën çështje, nëse shkalla e dytë gjyqësore vendos që ta aprovoj ankesën e paditësit në rastin KA.nr. 428/22 të kësaj gjykate dhe ta detyroj shkallën e parë që të vendosë meritorisht për kërkesën e Paditësit për vendosje sipas nenit 68 të LKA-së.

Prandaj gjykata gjeti se në këtë rast duhet të pritët vendimi i instancës së dytë gjyqësore në lëndën KA.nr. 428/22, dhe pas pranimit të atij vendimi të shqyrtohet padia e Paditësit. Në këtë rast gjykata e vlerëson si çështje paraprake zgjidhjen e ankesës së Paditësit ndaj aktvendimit KA.nr. 428/22 të datës 03.04.2024 të kësaj gjykate, rrjedhimisht në bazë të nenit 32 të LKA-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.428/2022

## Gjyqtari

---

Arben Toska

**UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.